



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna Drenas/Gllugoc

Zyra e Personelit

01Nr. MM/21-21174 dt. 19/04 /2019

Bazuar në nenin 3 paragrafi 2, nenin 11 paragrafi 1, neni 12 paragrafi 3, neni 18 paragrafi 1, nenin 20 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenet 14,15,16 të Rregullorës Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit të Nëpunësve Civil, Komuna Gllugoc/Drenas, shpallë:

KONKURS PUBLIK

Për pozitat : 2 Zyrtar për Ndërtimtari

Emri i institucionit rekrutues:	Komuna Drenas/Gllugoc
Nr. references:	RN00004735
Pozita e punës:	Zyrtar për Ndërtimtari
Institucioni:	Drejtoria për Infrastrukturë Publike
Divizioni/njësia:	Spektori i Ndërtimtarisë
Lloji i pozitës:	të Karrierës
Tipi i akt emërimit të punës:	Orar të Plotë
Pozita e punës së mbikëqyrësit:	Drejtori
Kategoria Funksionale –Grada	Niveli Profesional, grada 10, Koeficienti 6
Mbulesë buxhetore si pas Ligjit të Buxhetit:	Po
Procedura e Aplikimit:	1 Jashtëm
Numri i kërkuar:	2 punëtor/e
Kohëzgjatja e emërimit:	1 përhershëm
Kategoritë funksionale dhe gradat e punës, vendndodhja e pozitave:	Niveli Profesional, grada 10, Koeficienti 6, Drejtoria për Infrastrukturë Publike , Komuna Drenas.

Detyrat Kryesore:

1. Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet, në koordinim me mbikëqyrësin, për zbatimin e projekteve, shërbimeve dhe produkteve përkatëse në fushën profesionale specifike hartimin e paramasave, mbikëqyrjen profesionale , pranimin e projekteve ;
2. Kryen detyra e parapara në planet e punës të miratuara në përputhje me ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara;
3. Bën hartimin e paramasave dhe paralogarive për projekte për nevoja të institucionit;
4. Udhëheq grupet punuese në fushën profesionale specifike kur kërkohet një gjë e tillë;
5. Ofron këshilla për stafin e nivelit më të ulët brenda njësisë organizative ;
6. Ofron këshilla në fushën e ekspertizës të kërkuar brenda institucionit;
7. Koordinon punën me pjesët tjera të institucionit dhe komunikon, sipas nevojës, me autoritetet e jashtme;
8. Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe;

Kualifikimi i nevojshëm arsimor:(aftësitë, përvoja si dhe shkathtësitë tjera që kërkohen për këtë vend të punës):

Diplomë universitare, dy (2) vite përvojë pune profesionale;

- Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës- Drejtimi Konstruktiv
- Njohuri dhe përvojë substanciale në lëmin e ndërtimit .
- Aftësi komunikuese, negociuese;
- Shkathtësi në caktim të objektivave , planifikim të punës dhe analizë ;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, AutoCad);

Vendi ku mund të merren dhe të dorëzohen aplikacionet:

Në objektin e komunës, kati i parë sporteli nr.10-12,gjatë orarit të punës, Qendra për Shërbimin e Qytetarëve.

Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës dhe dokumentet e bashkangjitura aplikacionit duhet të jenë kopje të noterizuara dhe nuk kthehen.

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet e KKosovës.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të parapara nuk pranohen, të mangëtat refuzohen.

Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten: kopje e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, përvojës së punës, çertifikata e kandidatit që nuk është nën hetime, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme të kërkuara sipas kriterëve të konkursit.

Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike, që nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik, në një gazetë të përditëshme dhe në web-faqen e Komunës, nga data 19/04/2019 deri më 03/05/2019, për pozitat e cekura më lart.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër (ngushtë) njoftohen përmes faqesë së komunës dhe shalljes në hyrje të komunës.

U.D.Udhëheqëse e Personelit
Hanumshah Shabani

